



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
ZYRA E KRYETARIT

01 Nr. 111/01-21150, dt. 06.05.2019

Bazuar në nenin 4 paragrafi 5, neni 19 e neni 29 paragrafi 1 të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, neni 5 paragrafi 3 të Rregullores nr.21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil, komisioni për shqyrtimin e konkursit dhe zhvillimin e procedurave për vendin e lirë të punës (pozitën): Udhëheqës për Komunikim me Publikun-IN/010 i shpallur me dt.19/04/2019, me nr.prot.111/01-21150, bënë këtë:

N J O F T I M

Komisioni në përbërje të plotë ka mbajtur takim pune lidhur me shqyrtimin e dokumentacionit të pjesëmarrësve në konkurs për vendin e punës: Udhëheqës për Komunikim me Publikun-IN/010. Në bazë të konkursit janë përshkruar detyrat dhe përgjegjësit si dhe dokumentacionet që aplikantët duhet të dorëzojnë (plotësojnë) për t'i përmbushur kriteret për praninë në vendin e kërkuar të punës.

Komisioni për shqyrtimin e konkursit dhe zhvillimin e procedurave për vendin e lirë të punës: Udhëheqës për Komunikim me Publikun-IN/010, ka konstatuar se sipas nenit 5 paragrafi 3 të rregullores nr.21/2012 për avancime në Karrierë të Nëpunësve Civil, duhet të aplikojnë me së paku tre kandidat brenda njësisë së caktuar, në këtë rast ka vetëm një kandidat që ka aplikuar për vendin e punës: Udhëheqës për Komunikim me Publikun-IN/010.

Në bazë të kësaj dhe kushteve të përcaktuara në konkursin e shpallur për këtë vend pune, komisioni vendosi që t'i drejtohet me këtë shkresë zyrtare Zyrës së Personelit për **Anulimin e Konkursit**, për vendin e punës: Udhëheqës për Komunikim me Publikun-IN/010 i shpallur me dt.19/04/2019, me nr.prot.111/01-21150.



Kryesues i Komisionit

Elaki Bekolli